



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 365/2023

(Lidhja KPPP.nr.1996/22, PPP.nr.161/22)

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, me bashkëpunëtoren profesionale Yllka Pajaziti Abdullahu, në çështjen juridike përbarimore të Kreditorit Dardafon.net L.L.C. (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) me numër unik identifikues 810745416, me seli në fshatin Miradi e Epërme, Rruga Dëshmori p.n., Komuna e Fushë Kosovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat A.M. me seli të zyrës në Prishtinë, kundër debitorit Telekom i Kosovës Sh.A. me numër unik identifikues 81128800 me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson L.S. – Zëvendës Drejtor i Korporatës për çështje ligjore, F.K. - Zyrtar kryesor i financave si dhe Avokat A.K. me seli të zyrës në Prishtinë, që ka të bëjë me realizimin e detyrimit sipas dokumentit përbarimor me titull ekzekutiv / *Vendimit Përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr. 20990/MHM, datë 9 dhjetor 2016, i shpallur si vendim i ekzekutueshëm me Aktvendimin IV.C.nr.388/18 datë 11.02.2018 nga Gjykata Themelore e Prishtinës – Departamenti për çështje ekonomike, duke vendosur (I) sipas prapësimit të debitorit të datës 18.07.2019 kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.491/19 datë 15.07.2019 të Përbaruesit Privat Ilir Z. Mulhaxha, i plotësuar me parashtrësën e dt. 10.10.2022, duke vendosur (II) për propozimin e debitorit sa i përket **caktimit të masës së përkohshme për pezullim të procedurës së përbarimit** dt. 14.01.2022, duke vendosur (III) për propozimin e debitorit për **caktimin e masës së sigurimit** në këtë procedurë sipas parashtrësës për plotësim të prapësimit, si dhe duke vendosur (IV) për **Ankesën lidhur me parregullsitë e Organit Përbarues** me rastin e kryerjes së përbarimit dt. 14.11.2022 (çështja në rivendosje me Aktvendimin Kom.Dh.Sh.II Nr.1647/2022 datë 23.02.2023), jashtë seancës gjyqësore me datë 17.07.2023, mori këtë:*

## AKTVENDIM

- I. REFUZOHEË NË TËRËSI e pabazuar Ankesa e Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A. e datës 14.11.2022 lidhur me parregullsitë e organit përmbartues Ilir Z. Mulhaxha me rastin e kryerjes së përmbartimit të Urdhrit P.nr.479/19 dt. 15.07.2019.
- II. REFUZOHEË NË TËRËSI Propozimi i Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A. për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit për pezullim të procedurës përmbartimore P.nr. 491/19 dt. 15.07.2019, sipas parashtrësës së dt. 14.01.2022.
- III. REFUZOHEË NË TËRËSI Propozimi i Debitorit për caktimin e masës së sigurimit i datës 10.10.2022, i përsëritur në datën 4 dhe 25 prill 2022, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet Kreditori Dardafon.net LLC që deri në përfundim të procedurës gjyqësore përmbartimore, të deponojë në llogari të gjykatës apo në një llogari tjetër të veçantë mirëbesimi, mjetet e inkasuara përtej lartësisë së titullit ekzekutiv, në vlerë (të paktën) 13'116'165.73€ (*trembëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë e tre cent*) apo në vlerën e cila do të precizohet sipas gjetjes nga ekspertiza e re gjyqësore financiare nga grupi i ekspertëve.
- IV. REFUZOHEË NË TËRËSI I PABAZUAR Prapësimi i Debitorit i dt. 18.07.2019 dhe plotësimi i prapësimimit me parashtrësën e dt. 10.10.2022, ashtu që mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor i Përmbartuesit Privat Ilir Z. Mulhaxha P.nr.491/19 dt. 15.07.2019.
- V. DETYROHEË Debitori Telekom i Kosovës Sh.A. që në emër të borxhit të pa përmbushur sipas dokumentit përmbartimor me titull ekzekutiv / Vendimit Përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr. 20990/MHM, datë 9 dhjetor 2016, t'ia paguaj Kreditorit Dardafon.net LLC shumën në lartësinë 5'732'871.34 € (*pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent*), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

## A r s y e t i m

### I. Historiku i çështjes / përmbledhje e pretendimeve të palëve

1. Përmbareuesi Privat në cilësinë e organit përmbareues, me Urdhrin Përmbareimor P.nr.491/19 datë 15.07.2019, konform propozimit për përmbareim të Kreditorit Dardafon.net LLC datë 08.07.2019 e ka caktuar përmbareimin ndaj debitorit Telekom i Kosovës Sh.A. në bazë të dokumentit përmbareimor me titull ekzekutiv / Vendimit Përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr. 20990/MHM, datë 9 dhjetor 2016, i shpallur si vendim i ekzekutueshëm me Aktvendimin IV.C.nr.388/18<sup>1</sup> datë 11.02.2018 nga Gjykata Themelore e Prishtinës – Departamenti për çështje ekonomike.
2. Sipas propozimit të Kreditorit, Përmbareuesi Privat ka lejuar ekzekutimin e urdhrin përmbareimor P.nr.491/19 datë 15.07.2019 me këtë përmbajtje:
  - a) Për dhe në emër të shpërblimit të dëmit shumën 8'785'000.00 €, me kamatë ligjore 8 % në vit duke filluar nga data 14.04.2015 deri në pagesën përfundimtare;
  - b) në emër të fitimit të humbur shumën prej 17,315.000.00 €, me kamatë ligjore 8 % në vit duke filluar nga data 14.04.2015 deri në pagesën përfundimtare;
  - c) shumën prej 5,000.00 € në ditë duke filluar nga data 09.12.2016 (si datë e vendosjes sipas vendimit të Arbitrazhit) deri me datën 24.05.2017 (ndëshkimi kontraktues) për shkak të vonesës me ofrimin e numrave mobil dhe ofrimin e shërbimeve 3G dhe 4G nga pika a) dhe b) si më lartë;
  - d) 972,121.22 € dhe shumën prej 534.000.00 USD me kamatë ligjore 8% duke filluar nga data 9.12.2016 e deri në pagesën përfundimtare;
  - e) nga tërësia e pikave si më lartë të urdhëruara nga Tribunali i Arbitrazhit, të zbritet shuma 10,156,491.23 € e paguar nga debitori.

në emër të shpenzimeve të përfaqësimit në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit të Vendimit

---

<sup>1</sup> Pas trajtimit të ankesës kundër vendimit IV.C.nr.388/18 datë 11.02.2018, Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ae.nr.88/2019 dt. 01.04.2019 të njëjtën e ka hedhur poshtë si të palejueshme.

të Arbitrazhit, shumën 2,150.00 € shpenzimet e përfaqësimit të avokatit në procedurë përbarimore sipas Rregullores për Tarifat e Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), nga fillimi e deri në përfundimin e saj, dhe shpenzimet përbarimore të përcaktuara sipas pasqyrës së Përbaruesit Privat të përpiluar në kuptim të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2014.

3. Në rast të mos pagesës nga Debitori për pikat e lartë cekura, caktohet përbarimi i dhunshëm, ashtu që shuma e borxhit të realizohet përmes zbatimit të përbarimit nga llogaritë bankare të debitorit, dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë bankare të përbaruesit privat. Nëse, me rastin e përbarimit të dhunshëm nuk ka mjete të mjaftueshme financiare në llogaritë bankare të debitorit, atëherë përbarimi të ekzekutohet përmes mjeteve financiare nga shitja e pasurisë së luajtshme dhe e paluajtshme e debitorit.
4. Kreditori i çështjes ka iniciuar procedurën përbarimore ndaj debitorit, pasi që i njëjti ka shkëputur Marrëveshjen për Ekzekutimin e Vendimit të Arbitrazhit e datës 24.05.2017, për shkak të mospërbushjes së veprimeve të caktuara nga ana e debitorit si në këtë marrëveshje, pasi që i njëjti ka ndjekur procedurën ligjore për njohje dhe shpallje të ekzekutueshme të vendimit të Arbitrazhit në rrugët gjyqësore.
5. Kundër urdhrin të përbaruesit privat mbi caktimin e përbarimit, brenda afatit të rregullt ligjor ka ushtruar prapësim debitori i përbarimit, dhe atë me parashtresën e datës 18.07.2019, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përbarues të lejuar, me kërkesën që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhri përbarimor P.nr.491/19 datë 15.07.2019, për arsyet si në vijim:
  - mos ekzistimi i titullit ekzekutiv dhe tipareve të përbarueshmërisë, gjegjësisht mosekzistimi i klauzolës së përbarueshmërisë dhe papërshtatshmëria e kërkesës për përbarim;
  - pa pajtueshmëria në kryerjen e veprimeve përbarimore;
  - Lidhja e Marrëveshjes në mes të palëve në procedurë për ekzekutimin e vendimit final të Arbitrazhit OEN 20990/MHM datë 9.12.2017 (Marrëveshje për Ekzekutim) datë 24.05.2017, përmbajtjen e së cilës palët e kanë vërtetuar pranë Noter S.B., me aktin

“Vërtetim i dokumentit privat” LRP.6316/2019 dhe Ref. 1202/2017, me të cilën Kreditori është pajtuar që të mos kërkojë përmbartimin e Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit.

- Si dëshmi e zotimit nga marrëveshja e lartëcekur, Kreditori kishte tërhequr propozimin për njohje dhe ekzekutim Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit OEN 20990/MHM datë 9.12.2017, sipas të cilit veprim, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike kishte nxjerrë Aktvendimin me çka ka konstatuar se Kreditori ka tërhequr propozimin e datës 07.03.2017 kundër Debitorit.
  - Meqenëse Kreditori e ka shkëputur Marrëveshjen për ekzekutimin e vendimit final të Arbitrazhit, dhe Debitori nuk e kishte kundërshtuar shkëputjen, ky i fundit kundërshton vlefshmërinë dhe pasojat juridike të kësaj shkëputje, sepse Kreditori ka hequr dorë nga përmbartimi i Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit 20990/MHM të datës 09.12.2019, dhe ky zotim duhet të trajtohet si zotim në fuqi, konform zbatimit të “*Doktrinës Separate*” dhe objektivisht paraqet bazë e mjaftueshme për një prapësim të suksesshëm duke u mbështetur në nenin 71.1.3 të LPP-së.
  - Kreditori ka dështuar të paraqesë shumën e saktë dhe të qartë të kërkesës për përmbartim, si për nga lartësia ashtu dhe vëllimi i procedurave që do ndiqen për përmbartim.
6. Kreditori i përmbartimit ka parashtruar përgjigje në prapësim me parashtresën e datës 24.07.2019 me çka ka theksuar se i demanton pretendimet e debitorit në çdo pikë. I njëjti përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se Propozimi për përmbartim është iniciuar në bazë të dokumentit me titull ekzekutiv, respektivisht Vendimit përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit 20990/MHM datë 19.12.2016, i shpallur si i ekzekutueshëm me vendimin përkatës gjyqësor nga IV.C.nr.388/18 datë 11.02.2018 nga Gjykata Themelore e Prishtinës – Departamenti për çështje ekonomike. Nga kjo, Vendimi i Arbitrazhit në fjalë është titull ekzekutiv sipas nenit 24 par. 1 të LPP-së. Lidhur me përshtatshmërinë e përmbartimit të dokumentit në fjalë, Kreditori ka theksuar se petitumi i vendimit të Arbitrazhit nuk është i diskutueshëm por vetëm i zbatueshëm në suaza të vlerësimit dhe ekzekutimit të titullit përmbartimor që cilësohet të ketë i njëjti, dhe për këtë ka shtuar se i plotëson të gjitha kërkesat nga neni 27 i LPP-së.
7. Sa i përket kundërshtimit të debitorit për lartësinë e borxhit, kreditori ka theksuar në propozimin për përmbartim ia ka njohur debitorit pagesat e kryera të cilat arrijnë lartësinë e

shumës 10'156'491.23€ (*dhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një euro e njëzet e tre cent*), dhe këto nuk i ka kërkuar në lartësinë e përgjithshme të shumës së kërkuar për përmbarim; mirëpo është vetë debitori i cili nuk e ka precizuar asnjëherë shumën përkatëse të paguar ndaj kreditorit gjegjësisht nuk ka saktësuar lartësinë e pagesave të kryera nga detyrimi që del prej Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit, dhe më tutje në procedurë nuk e saktëson të njëjtën me prapësimin e tij.

8. Tutje, Kreditori ka theksuar se pretendimet që debitori ka rreth ekzekutimit të Marrëveshjes për zbatimin e Vendimit të Arbitrazhit dhe shkëputjes së saj apo heqjes dorë nga përmbarimi i Vendimit të Arbitrazhit, është dashur që të njëjtat ti adresojë në procedurën e njohjes dhe shpalljes së ekzekutueshme të Vendimit të Arbitrazhit dhe jo në procedurë përmbarimore.
9. Sa i përket pretendimit lidhur me vëllimin dhe shtrirjen e përmbarimit, kreditori thekson se në rast s enë llogaritë bankare të debitorit nuk ka mjete të mjaftueshme për realizim të përmbarimit, atëherë qartë përcaktohet se përmbarimi do të ekzekutohet përmes mjeteve financiare nga shitja e pasurisë së luajtshme dhe e paluajtshme e debitorit, konform me dispozitat e zbatuara të Ligjit për procedurën përmbarimore.
10. Lidhur me ngritjen e pretendimit të "*Doktrinës Separate*" nga ana e Debitorit, Kreditori ka theksuar se e njëjta nuk gjen zbatim në këtë rast meqë në nenin 8.3 të Marrëveshjes së datës 24.05.2017 përcaktohet se në rast të mospërmbushjes së marrëveshjes, Kreditori e shkëputë kontratën dhe mund të iniciojë procedurën e ekzekutimit të Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit. Poashtu me nenin 114 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve përcaktohet qartë se detyrimet kontraktuese shuhet me rastin e shkëputjes së kontratës, dhe pas kësaj Kreditori e ka kryer me sukses në të gjitha instancat procedurën e njohjes dhe ekzekutimit të Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit.
11. Nga sa u tha më lartë, meqenëse Debitori ka dështuar t'i bëjë të besueshme me prova pretendimet e tija të ngritura me prapësim, në kuptim të përmbushjes së ndonjërit nga kushtet e nenit 71 të LPP-së, e posaçërisht të mbështesë faktin se dokumenti përmbarimor duhet shfuqizuar, Kreditori i ka propozuar gjykatës që të nxjerrë Aktvendim me të cilin do ta

refuzojë në tërësi si të pabazuar Prapësimin e debitorit TK SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.491/19 datë 15.07.20119.

12. Pas mbajtjes së seancës dëgjimore në instancën gjyqësore të shkallës së parë, me parashtrësën e dt. 29.06.2020 Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar – sipas Konkluzionit burimor të dhënë nga Gjykata Themelore e Prishtinës në seancën e datës 22.06.2020, e ka precizuar kërkesën e përmbarrimit dhe atë në lartësinë 24'684'003.15€ (njëzet e katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tre euro e pesëmbëdhjetë cent) duke ia shtuar kamatën ligjore 8% në vit nga data 08.07.2016 e deri në pagesën përfundimtare, përjashtimisht shumave nga pika e llogaritjes së ndëshkimit të kontraktuar në bazë ditore nga 5'000.00€ për periudhën 09.12.2016-24.05.2017, dhe shpenzimet e tërësishme të përfaqësimit në procedurën e arbitrazhit të llogaritura në lartësinë 972'121.22€ plus shuma 534.000.00 USD (505'730.00€ sipas kursit zyrtar valutator të dt.08.07.2019), e cila vlerë përfundimtare është arritur pas zbritjes së shumës së përgjithshme të paguar nga debitori në lartësinë 10'471'305.66€.

13. Debitori i çështjes përmbarrimore është deklaruar përmes parashtrësës së dt. 07.07.2020 lidhur me precizimin e propozimit për përmbarrim të kreditorit, të cilin e ka kundërshtuar në kuptimin formal për paraqitje të precizimit pas afatit të dhënë nga Gjykata, dhe në kuptimin material për shkak të vlerës së definuar të tërësishme të kërkesës së kreditorit e cila (24'684'003.15€) nuk është vendosur në mënyrë të tillë në titullin ekzekutiv të Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit, kjo vlerë as nuk është dhënë në Urdhrit përmbarrimor P.nr.491/19 datë 15.07.20119, dhe për këtë vlerë as nuk është ushtruar prapësim. Nga këto arsye, meqenëse në procedurë përmbarrimore pranë gjykatës vendoset sipas validitetit të prapësimit dhe propozimeve të Kreditorit, Debitori i çështjes i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i tij si i bazuar dhe të shfuqizohet Urdhrit Përmbarrimor P.nr.491/19 datë 15.07.20119 në tërësi.

### ***1.1.Vendimet paraprahe gjyqësore***

14. Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr.1486/19 të datës 06.07.2020, ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit TK Sh.A. lidhur me shumën 315,996.85 €, ashtu

që në këtë shumë e ka shfuqizuar Urdhrin e Përmbaresit Privat Ilir Z. Mulhaxha - P.nr.491/2019 të datës 15.07.2019, ndërsa në pjesën tjetër të detyrimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke e lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor sa i përket shumës 24,684,003.15 €.

15. Pas parashtrimit të Ankesës së debitorit, datë 15.07.2020 për shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ac.nr. 3610/20 datë 08.07.2020 ka refuzuar ankesën e debitorit të përmbarimit dhe ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1486/2019 të datës 06.07.2020.
16. Me kërkesën e debitorit të përmbarimit për të ngrehë Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë përmes Prokurorisë së Shtetit, KMLC.nr.152/2020 të datës 10.11.2020, është kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër PPP.nr.1486/19 datë 06.07.2020, e po ashtu të anulohet Aktvendimi i Gjykatës së Apelit me numër Ac.nr.3610/20 datë 08.10.2020 dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, nën pretendimin se Aktvendimet e lartpërmendura janë përfshirë në shkelje të procedurës Kontestimore nga neni 247 par.1 pika a) lidhur me nenin 5 par. 5.1 e Ligjit të procedurës kontestimore (LPK).
17. Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin me numër CML.nr.12/20 të datës 20.01.2021 e ka refuzuar Kërkesën e Prokurorit të Shtetit për Mbrojtje e Ligjshmërisë të paraqitur për shkaqet dhe kundër vendimeve të lartë cekura.
18. Debitori i përmbarimit ka parashtruar Kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës CML.nr.12/20 datë 20.01.2021, për shkak të shkeljes së ligjit gjatë zbatimit të procedurës përmbarimore nën pretendim të shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe shkeljes së parimeve të kontraditoritetit dhe barazisë së palëve në procedurë, si dhe shkeljen e të drejtës për një vendim të arsyetuar. Mes tjerash parashtruesi / këtu debitori kishte kërkuar edhe vendosjen e masës së përkohshme në mënyrë që të pezullohet menjëherë zbatimi i përmbarimit.



19. Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktgjykimin numër rastin nr. KI 84/21 të datës 17.12.2021 për çështjen meritorë (mes tjerash) kishte vendosur;
- TA DEKLARUJE, njëzëri, kërkesën e parashtruesit – këtu debitorit si të pranueshme;
  - TË KONSTATOJË, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës të Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
  - TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM, me shumicë votash, Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, CML.nr.12/20, të 20 janarit 2021 dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3610/20 të 8 tetorit 2020;
  - TË KTHEJË, me shumicë votash, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3610/20 të 8 tetorit 2020, për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.
  - TË REFUZOJE, njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme.
20. Konform vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin me numër Ac.nr.265/22 të datës 07.02.2022 e aprovon si të themeltë Ankesën e Debitorit T.K. Sh.A. datë 15.07.2020, e anulon Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër PPP.nr.1486/19 të datës 06.07.2020 dhe çështjen ia kthen të njëjtës gjykatë sërish në procedim. Në këtë vendim Gjykata e Apelit kishte dhënë udhëzime se në ri-procedurë që Gjykata e shkallës së parë duhet të caktojë seancë dëgjimore me qëllim të dëgjimit të pretendimeve të palëve sa i përket lartësisë së borxhit, po ashtu të vlerësojë propozimin për masë të përkohshme të debitorit në procedurë (sipas parashtrësës së datës 14.01.2022), me të cilën ka kërkuar pezullimin e procedurës së përmbarimit të iniciuar sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.491/19 dt. 15.07.2019.
21. Konform kompetencave të zbatuara sipas Ligjit NR. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale Neni 13 par. 1.2. (pas themelimit dhe funksionalizimit të saj), çështja përmbarimore në mes të palës kreditore dhe debitore është transferuar për vendosje në datë 01.08.2022 dhe ka marrë numër të regjistrimit KPPP 1996/22 (Lidhja nga Gjykata Themelore e Prishtinës PPP.nr.161/22) për trajtim në ri-procedurë.
22. Kjo gjykatë – Dhomat e shkallës I, Departamenti për çështje ekonomike duke u mbështetur në udhëzimet e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.265/22 të datës 07.02.2022, ka

caktuar seancë dëgjimore me palët në këtë procedurë, e cila është mbajtur në datën 10.10.2022 me përfaqësuesit e tyre të autorizuar. Sipas Aktvendimit burimor të gjykatës, palët kanë sjellë në cilësi prove dëshmitë e pagesave dhe transaksioneve të kryera në emër të përmbushjes së detyrimit që buron nga Vendimi përfundimtar i Arbitrazhit dhe Marrëveshja për Ekzekutimin e Vendimit të Arbitrazhit e datës 24.05.2017, si dhe kanë paraqitur dëshmitë përkatëse për realizimin e një pjese të kërkesës në procedurën e ekzekutimit të Urdhrit nga ana e organit përmbarues. Konkretisht palët kishin paraqitur këto dëshmi me parashtresat e dt. 17.10.2022 (Dok. i Kreditorit “Raport lidhur me pagesat e kryera për përmbushjen e kërkesës – kredisë së Kreditorit”, dhe Dok. i Debitorit “Raport financiar me specifikacionet e pagesave të paguara nga debitori TK Sh.A. ndaj kreditorit Dardafon.net LLC”).

23. Kreditori është deklaruar në seancë dëgjimore dhe ka theksuar se qëndron edhe më tej pranë të gjitha deklarimeve të deritanishme duke kërkuar nga gjykata që të sjell aktvendim me të cilin refuzohet në tërësi prapësimi i ushtruar nga debitori dhe të lihet në fuqi urdhëri përmbarimor me numër P.nr.491/2019 dt.15.07.2019, i lëshuar nga përmbaruesi privat Ilir Mulhaxha, dhe të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra në përputhje me këtë urdhër përmbarimor të lejuar nga përmbaruesi privat. Po ashtu i njëjti kishte kërkuar që të urdhërohet Përmbaruesi Privat që të vazhdoj me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore lidhur me realizimin e pjesës së pa përmbushur të kërkesës – kredisë së kreditorit. Tutje pala ka sqaruar se pas plotfuqishmërisë së urdhrit ka arritur të inkasoj një pjesë të kërkesës e po ashtu një pjesë e kërkesës është përmbushur me vullnetin e debitorit, por e cila është ndërprerë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

24. Kreditori ka sqaruar se palët ndërgjyqëse në procedurë të përmbarimit në përputhje me urdhrin përmbarimor respektivisht parashtresën për precizim, me datë 17.11.2020, kishin lidhur Marrëveshje për përmbushjen e borxhit me anë të kësteve, për pjesën deri në atë fazë e cila kishte mbetur e pa inkasuar nga ana e përmbaruesit. Tutje ka theksuar se vetë fakti që palët kishin lidhur marrëveshje në procedurë të përmbarimit për pagesën e kërkesës me këste, dhe se debitori në njërën anë e ka pranuar vetë kërkesën e kreditorit, nuk duhet të merren parasysh fare qëndrimet e tij sepse i njëjti është duke keqpërdorur të drejtat procedurale me qëllim të prolongimit të procedurës përmbarimore, e që këtë ka tentuar ta bëjë edhe me paraqitje të propozimeve të llojllojshme.

25. Sa i përket zbatimit të marrëveshjes për përmbushje të detyrimit me këste, Marrëveshja e datës 17.11.2020 e lidhur mes palëve në procedurë, Kreditori kishte deklaruar se janë paguar 14 nga 24 këste dhe kanë mbetur pa u paguar edhe 10 këste të tjera, totali i vlerës së të cilave kap shumën 7'499'736.00 € (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë euro), shumë e cila duhet paguar ashtu që të përmbushet kërkesa e kreditorit në tërësi.

26. Në seancën dëgjimore të datës 10.10.2022, Debitori i çështjes, përmes parashtrësës së dorëzuar gjykatës e ka plotësuar Prapësimin e tij ndaj Urdhrit përmbarimor P.nr.491/19 datë 15.07.2019, të cilën e ka parashtruar duke marrë për bazë zhvillimin e procedurës në këtë çështje përmbarimore me shterjen e mjeteve juridike deri në parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit Gjyqësor - Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës CML.nr.12/20 datë 20.01.2021. Në këtë plotësim, Debitori i ka kërkuar gjykatës që:

- Të caktohet Masa e Sigurimit deri në marrjen e vendimit meritore për rastin e Urdhrit Përmbarimor Nr. 491/19 dhe të kthehen mjetet e paguara deri më tani sipas këtij urdhri një llogari tjetër apo sipas vlerësimit të gjykatës.
- Të aprovohet si i themeltë prapësimi i debitorit dhe të Anullohet në tërësi Urdhri përmbarimor Nr. 491/19 si dhe veprimet e ndërmarra përmbarimore.
- Të refuzohen të gjitha pretendimet e Kreditorit për realizimin e borxhit pasi që kërkesa e tij nuk reflekton në detyrimin real dhe janë në kundërshtim me dokumentin përmbarimor / Vendimin Përfundimtar të Arbitrazhit.
- Alternativisht të caktohet nxjerrja e provës me ekspertizë financiare e cila do të besohet një institucioni profesional për të vlerësuar detyrimin e debitorit karshi kreditorit, sipas argumenteve të ngritura në prapësim dhe plotësimin e tij.

27. Në mbështetje të propozimeve që i kishte bërë gjykatës, Debitori ka sqaruar në seancë dëgjimore përmes deklaramit nga përfaqësuesit e autorizuar se pala debitore është bazuar në

udhëzimet e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.265/22 të datës 07.02.2022, dhe mbështetur në udhëzimin e kësaj gjykate, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike rreth detyrimeve monetare, të cilat burojnë nga dokumenti përmbarues, duhet të caktohet nxjerrja e provës me ekspertizë financiare, konform nenit 358.4 dhe 366 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) lidhur me nenin 17 të LPP-së.

28. Tutje, Debitori konsideron se detyrimet që burojnë nga dokumenti përmbarues i konteston në 5 pika dhe atë:

28.1.Përfshirja në shumën e borxhit në urdhrin përmbarimor dhe në marrëveshjen e vitit 17.11.2020, është në kundërshtim të plotë me pikën V. të vendimit të arbitrazhit si dokument përmbarimor, sepse në kërkesën e përmbarimit është llogaritur kamatëvonesa ditore e llogaritur përfundimisht në lartësinë 1'660'000.00 € (Një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë euro) me kamatë ligjore e cila është në kundërshtim me përmbajtjen e vendimit të Arbitrazhit.

28.2.Sipas Marrëveshjes për ekzekutim të Vendimit të Arbitrazhit, e lidhur mes palëve në muajin Maj 2017, debitori ka theksuar se detyrimi i tërësishëm i llogaritur në atë kohë së bashku me kamatën ligjore kapte vlerën 32'000'000.00€ (tridhjetë e dy milionë euro), dhe palët ishin dakorduar që Debitori fillimisht t'i paguajë Kreditorit 4'500'000.00€ (katër milionë e pesëqind mijë euro) me para kesh, ndërsa pjesa tjetër e borxhit të shlyhej me kompensim përmes dhënies së 90.000 (nëntëdhjetë mijë) numrave shtesë dhe shërbimeve 3G dhe 4G deri me 31.12.2023, ashtu që në këtë formë borxhi do të konsiderohej i paguar. Thënë ndryshe nga kompensimi përmes numrave dhe shërbimeve 3G dhe 4G do të shlyhej çdo muaj shuma e borxhit nga 384'101'26 € (treqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e një euro e njëzet e gjashtë cent). Debitori ka theksuar se pasi është nënshkruar marrëveshja, e kishte paguar shumën prej 4'500'000.00€ (katër milionë e pesëqind mijë euro) me para kesh - e cila shumë nuk kontestohet as nga ana e kreditorit, e po ashtu kishte plotësuar edhe kushtin tjetër duke i dhënë numra shtesë dhe shërbimet 3G dhe 4G kreditorit. Mirëpo, me 26.04.2018, kreditori ka njoftuar për shpëputje të marrëveshjes dhe më tej ka vazhduar përdorimin e numrave mobil dhe shërbimeve shtesë nga e cila do të gjeneronte të ardhura deri me

datën 30.11.2019 për gjithsej 90 muaj, ndërkaq insiston në kërkesën e shumës së plotë të borxhit sipas marrëveshjes. Në këtë pikë nga sa u tha më lartë, debitori konsideron se kundërvlera e mbajtjes në shfrytëzim të këtyre numrave dhe shërbimit përkatës duhen të zvogëlohen nga borxhi që rrjedh nga Vendimi përfundimtar i Arbitrazhit, e të cilat shuma debitori i ka kalkuluar në dy variante: varianti i parë arrin shumën 10'443'038.00 € (dhjetë milionë e katërqind e dyzet e tre mijë e tridhjetë e tetë euro), ndërsa varianti i dytë arrijnë shumën 16'312'500.00 € (gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e dymbëdhjetëmijë e pesëqind euro). Për këto, Debitori po ashtu kërkon zbritjen e kamatës e cila është përlllogaritur.

28.3.Vendimi i arbitrazhit është marrë me datë 09.12.2016, ndërsa është njohur dhe shpallur i ekzekutueshëm nga gjykata vendore me datë 01.04.2019, andaj edhe i njëjti nuk është përmbushur për nga detyrimi për arsye se nuk ka qenë i përmbarueshëm. Rrjedhimisht kamatat e llogaritura gjatë kësaj periudhave e që janë të përfshira në urdhrin përmbarimor janë të pa bazuara dhe të kundërligjshme, sipas nenit 306 dhe 307 të LMD-së, sepse për shkak të vonesës së kreditorit është përcaktuar se pushon të rrjedh kamata. Kreditori kërkesën për njohje e ka paraqitur në gjykatë me datën 01.07.2018 ndërsa vendimin për njohje gjykata e ka marrë me 01.04.2019, që nënkuptohet se detyrimi për pagesë i debitorit fillon të rrjedh vetëm pas datës 01.04.2019, ndërsa kreditori dhe përmbaruesi në borxh e kanë përfshirë edhe kamatën para kësaj date në vlerën 5'887'076'77 € (pesë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent), të cilën Debitori kërkon nga gjykata që e njëjta të fshihet nga borxhi pasi që është në kundërshtim me dispozita të LMD-së.

28.4.Pas njohjes së vendimit të arbitrazhit kreditori ka kërkuar pagesën e obligimeve sipas kalkulimit të tyre në të cilin janë përfshirë edhe shumat e cekura në tri pikat e lartë cekura, çka e ka vendosur debitorin në pozitë të pafavorshme dhe në pamundësi për pagesë, nga çka pastaj Kreditori e ka iniciuar procedurën përmbarimore. Debitori pretendon edhe me tutje se kamatat e llogaritura për periudhën deri sa janë zhvilluar procedurat e përmbarimit nuk duhet të përfshihen në detyrim për shkak se zhvillimi i këtyre procedurave nuk i atribuohet debitorit. Shuma totale e kamatave të përfshira në detyrim në këtë periudhë janë 2'509'731.36 € (dy milionë e pesëqind e nëntë mijë e

shtatëqind e tridhjetë e një euro e tridhjetë e gjashtë cent), të cilat Debitori kërkon që të mos përfshihen në kërkesën e kreditorit.

28.5. Pas marrjes parasysh të vlerave më lartë dhe kalkulimeve të sakta të borxhit dhe pagesave të bëra deri më tani Debitori kërkoi nga gjykata që ta detyrojë Kreditorin që të kthejë diferencën e paguar më tepër së bashku me kamatën ligjore në lartësi 8 %. Sipas kalkulimeve të Debitorit - shuma totale e borxhit sipas Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit duhet të jetë 27'606'121.00 € (njëzetë e shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e një euro), ndërsa shuma totale e pagesave dhe kompensimeve tjera që ka bërë debitori ndaj kreditorit arrin shumën prej 40'694'016.75 € (dyzet milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëmbëdhjetë euro e shtatëdhjetë e pesë cent; Nga kjo shumë, vlera në lartësi 30'250'978.70 € (tridhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë euro e shtatëdhjetë cent) është konfirmuar si e paguar edhe nga vetë Kreditori, dhe dëshmohet lehtësisht me transfere bankare, nga çka i bie se shuma e paguar më tepër deri tani arrin vlerën 13'087'895.75 € (trembëdhjetë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë e pesë cent). Prandaj nga kjo gjendje, Debitori kërkon nga gjykata që të urdhëroj kreditorin që shumat e paguara t'i kthehen debitorit ose të mbahen në një llogari në mirëbesim deri në marrjen e vendimit meritor, për shkak se debitori rrezikohet që kreditori të tjetërsojë mjetet dhe të pamundësojë realizimin e kthimit.

29. Nga sa u shtjellua më lartë nga pretendimet e Debitorit, i njëjti ka theksuar se pas shqyrtimit të argumenteve dhe provave materiale të çështjes,

29.1. të aprovohet si e bazuar kërkesa e debitorit për caktimin e masës së sigurimit deri në marrjen e vendimit meritor për rastin e urdhrit përbarimor P.nr.491/19 i datës 15.07.2019;

29.2. të kthehen mjetet e përbaruara nga urdhri përbarimor P.nr.491/19 në llogarinë e debitorit apo në ndonjë llogari tjetër në mirëbesim sipas vlerësimit të gjykatës,

29.3. të aprovohet si i themeltë prapësimi debitorit, ashtu që të anulohet urdhri përbarimor P.nr.491/19 i datës 15.07.2019 si dhe të shfuqizohen të gjitha veprimet e ndërmarra përbarimore.

30. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës I, Departamenti për çështje ekonomike, pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve në procedurë si dhe pas marrjes në konsideratë të deklamimeve e provave të prezantuara nga seanca dëgjimore e mbajtur, erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit duhet aprovuar pjesërisht dhe me Aktvendimin KPPP.nr.1996/22 datë 27.10.2022 vendosi si në këtë përmbajtje:

- I. Aprovohet pjesërisht i bazuar prapësimi i Debitorit T.K. SH.A. dhe Shfuqizohet pika II (c) e dispozitivit të Urdhrit për Caktimin e Përmbartimit P.nr.491/19 datë 15.07.2019 e lëshuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha me seli të zyrës në Prishtinë, në shumën 1'660'000.00 €, së bashku me të gjitha kamatat që lidhen më këtë pikë të Urdhrit Përmbartimor.
- II. Refuzohet si i pa bazuar prapësimi i Debitorit T.K. SH.A. në lidhje me pikat tjera të Urdhrit për Caktimin e Përmbartimit P.nr.491/2019 datë 15.07.2019 të lëshuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha.
- III. Refuzohet si i pa bazuar Propozimi i Debitorit T.K. SH.A. për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

31. Të dyja palët në procedurë kanë parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të lartëcekur, Kreditori me datën 04.11.2022 dhe Debitori me datën 07.11.2022, nga të cilat Kreditori me Ankesë ka goditur pikën I të vendimit ndërkaq Debitori piken II dhe III.

32. Debitori i çështjes përmbartimore T.K. Sh.A. në këtë stad të procedurës ka parashtruar edhe Kërkesë për përjashtimin e përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha nga procedura përmbartimore, sipas parashtrësës së datës 02.11.2022, si dhe me parashtrësën e datës 07.11.2022 ka parashtruar Ankesë lidhur me parregullsitë në procedurën e përmbartimit nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha.

33. Kjo gjykatë me Aktvendimin KPPP.nr.1996/22 dt. 27.11.2022 e ka refuzuar si të pa bazuar Kërkesën e Debitorit për përjashtimin e përmbartuesit privat Ilir Mulhaxha nga procedimi i çështjes përmbartimore, pasi që vlerësoi se nuk gjendet rrethana të cilat mund të vejnë në dyshim paanësinë e organit përmbartimor në udhëheqje të procedurës dhe se nuk rezulton

dyshimi për shkelje të paanshmërisë në veprimet e ndërmarra përmbarimore, dhe nuk plotësohen asnjë nga kushtet e nenit 67 të LPK-së për përjashtim të përmbaruesit privat nga kjo procedurë. Dhoma e Shkallës II me Aktvendimin Kom.Dh.Sh.II. Nr.1647/22 datë 10.01.2023 e ka hedhur si te palejuar Kërkesën e përsëritur të Debitorit për përjashtimin e përmbaruesit privat.

34. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës II, ka trajtuar Ankesat e palës Debitore dhe Kreditore ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës I, dhe me Aktvendimin Kom.Dh.Sh.II. Nr.1647/22 datë 23.02.2023 ka vendosur si në vijim:

34.1. Refuzohet e pathemeltë ankesa e Kreditorit ndërsa pika I e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, KPPP.nr.1996/22 të dt. 27.10.2022 Vërtetohet.

34.2. Aprovohet e themeltë Ankesa e Debitorit, Priset Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë KPPP.nr.1996/22 të dt. 27.10.2022 në pikën II dhe III të dispozitivit, dhe çështja në këtë pjesë i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomave të shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

35. Lidhur me çështjen e kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, Dhoma e Shkallës II **ka udhëzuar Dhomat e Shkallës I që** duke marrë në konsideratë përfundimet e Gjykatës Kushtetuese me Aktgjykimin K184/21 par. 138, për dhënie të një verdikti të paanshëm pa lëshime procedurale dhe duke garantuar zbatimin e parimit të “barazisë së armëve” / barazisë së palëve në procedurë:

- të hapë seancë dëgjimore,
- të ftojë ekspertin financiar të angazhuar në procedurë që të japë sqarime dhe të mënjanojë paqartësitë apo mangësitë në dhënie të ekspertizës,
- të arsyetohet se cilat fakte u vërtetuan me provat e paraqitura / raportet financiare të pagesave të kryera nga palët në procedurë të cilat u dorëzuan pas seancës dëgjimore
- të shqyrtojë mundësinë e angazhimit të një grupi të ekspertëve për hartim të një ekspertize të re financiare,



- të përcaktojë dhe trajtojë nëse Debitori ka parashtruar Kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të përmbartimit apo vendosje të masës së sigurimit sipas dispozitave kontestimore,
- të vlerësojë mundësinë e vendosjes rreth Ankesës së Debitorit për parregullsitë me rastin e kryerjes së përmbartimit.

## ***II. Çështja në rivendosje***

36. Duke ndjekur udhëzimet e Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës II, me Aktvendimin Kom.Dh.Sh.II. Nr.1647/22 datë 23.02.2023 të cilat u përmbledhën si më lartë, kjo gjykatë ka thirrur sërish në seancë dëgjimore palë si në këtë procedurë, dhe ka dëgjuar shtjellimin e pretendimeve dhe propozimeve të bëra në këtë stad procedural, së bashku me ekspertin financiar të çështjes R.S., i cili është angazhuar nga organi përmbartues në procedurë për të llogaritur detyrimin e pa përmbushur të debitorit ndaj kreditorit. Konkretisht, kjo gjykatë ka mbajtur dy seanca dëgjimore dhe atë në datën 4 dhe 25 Prill 2023.

37. Në seancën e datës 25.04.2023 gjykata ka ftuar dhe dëgjuar Ekspertin financiar të çështjes R.S. lidhur me sqarimet që kishte për të dhënë rreth ekspertizës financiare dhe plotësimin e saj të punuar në procedurë përmbartimore sipas Konkluzionit të organit përmbartimor Ilir Mulhaxha.

### ***2.1.Pretendimet e palëve në procedurën e rishqyrtimit dhe rivendosjes***

38. Pretendimet e Kreditorit të çështjes në ri procedurë dhe rivendosje mbetën të njëjtat në tërësi, pa kundërshtime ndaj gjetjeve të ekspertizës financiare dhe plotësimit të saj, të realizuara në procedurë pranë organit përmbartues, me kërkesë që gjykata të refuzojë prapësimin si të pabazuar në tërësi dhe të lejë në fuqi urdhrin përmbartues sipas titullit ekzekutiv / Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit, gjegjësisht deri në përmbushjen përfundimtare të detyrimeve që dalin nga ky vendim. I njëjti ka kundërshtuar pretendimet e palës debitore në tërësi duke theksuar se pjesa dërmuese e çështjeve të ngritura janë të karakterit kontestues të kërkesës së kreditorit e që në procedurë përmbartimore nuk mund të shqyrtohen pasi që të njëjtat janë vendosur me vendimin e arbitrazhit. Tutje ka theksuar se “E ri njoftojmë gjykatën edhe një

*herë se këtu palët ndërgjyqëse kanë lidhur marrëveshje për ekzekutim të borxhit me dt. 17.11.2020 me nr. protokolli 01-156/09, në të cilën e kanë përcaktuar lartësinë e borxhit përjashtuar këtu shumën prej 1'660'000.00 €. (...) dhomat e shkalles së dytë siç rrjedh nga aktvendimi i dt. 23.02.2023 nuk kanë udhëzuar shkallën e parë që të caktojë grup të ekspertëve por vetëm t'i japë përgjigje pretendimeve te paraqitura nga debitori.”, duke vlerësuar kështu të panevojshme nxjerrjen e provës me ekspertizë të re financiare nga një grup i ekspertëve. Poashtu sa i përket kundërshtimeve rreth lartësisë së detyrimit të mbetur për pagesë nga ana e debitorit, kreditori ka theksuar se “për çfarë arsye vete kreditori dhe vetë debitori së bashku kanë definuar borxhin në përputhje me dokumentin përmbarimor, (...) Veprimi ku në njërën anë vetë debitori e definojnë borxhin kurse në anën tjetër më pas e kontestojnë të njëjtin, nuk është asgjë më pak e asgjë më shumë sesa keqpërdorim i të drejtave civile. Sikurse debitori me vullnetin e vetë të përmbushte detyrimin, kamatat fare nuk do të ishin rrjedhur por që një gjë të tillë nuk e ka bërë dhe tani kur në emër të kamatave duhet të paguajë mjetet e caktuara i njëjti ngrit lloj-lloj pretendimesh nga më të paqëndrueshmet.”*

39. Pretendimet e Debitorit të çështjes të ngritura në procedurën e rishqyrtimit dhe rivendosjes konsistojnë edhe më tej në aprovimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit, aprovimin e prapësimit si të bazuar, shfuqizimin e urdhrin përmbarimor në tërësi, dhe detyrimin e Kreditorit që të kthejë mjetet e përmbaruara përtej lartësisë së titullit ekzekutiv. Fillimisht deklarimeve të dhëna nga përfaqësuesit e autorizuar të debitorit në procedurën e rishqyrtimit, pas dëgjimit të eksperti financiar R.S. të thirrur në seancë, debitori i ka kundërshtuar gjetjet e tij edhe më tej, për çka ka konsideruar se ka paguar detyrimin përtej lartësisë së titullit ekzekutiv (dhe atë për shumën në vlerë 13'116'165.73 €) andaj edhe e ka kundërshtuar ekspertizën financiare si të mangët dhe jo profesionale. Pas parashtrimit të pyetjeve dhe përgjigjeve të marra nga eksperti financiar, debitori ka theksuar se përgjigjet e dhëna lidhur me kalkulimet financiare të kryera janë të pa sakta, të pa kjarta, jo të plota dhe kontradiktore si me vetveten ashtu edhe me provat e shkresat e lëndës. I njëjti konsideron se gjykata e faktit duhet të refuzojë si të pabazuar ekspertizën dhe plotësimin e sajë për arsyet e theksuara më lartë, ashtu që i ka propozuar gjykatës që të aprovohet nxjerrja e provës me ekspertizë financiare të re nga një institut i kualifikuar / grup i ekspertëve, konform dispozitave të nenit 358.4 dhe 366.2 të LPK-së.

40. Debitori më tej konsideron se ekspertiza financiare është punuar për një periudhë shumë të shkurtë kohore dhe e njëjta nuk reflekton mbi të gjitha pretendimet dhe barazimet e detyrimeve përpos me pagesa të kryera ashtu edhe me ofrim të shërbimeve nga ana e debitorit ndaj kreditorit. Ka shtuar se të gjitha arsyetimet dhe sqarimet e dhëna nga Debitori, në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare janë hedhur poshtë nga përmbartuesi privat, eksperti dhe kreditori, nga çka nuk është marrë parasysh pretendimi se debitori ka paguar me tepër se që është paraparë me vendimin e arbitrazhit, dhe atë shumën në vlerë 13'116'165.73 €. Meqenëse Kreditori i referohet marrëveshjes së datës 17.11.2020 për ekzekutimin e borxhit që buron nga Vendimi i Arbitrazhit, Debitori ka deklaruar rishtazi se kjo është lidhur nën kërcënim dhe detyrim për shkak se si pasojë të Aktvendimit të Gjykatës Themelore të muajit korrik të vitit 2020 llogaritë bankare të T.K. Sh.A. ishin të bllokuar për dy muaj rresht pa mundësi operimi, dhe nën këtë presion është detyruar të lidhë marrëveshje dhe të pranojë borxhin ashtu siç imponohej nga kreditori. Më tej mbetet paradoksale fakti se si kreditori nuk i pranon si kompensim shërbimet e pranuar sipas marrëveshjes me vullnet të lirë të vitit 2017 dhe në të njëjtën kohë insiston në një marrëveshje që qartazi shihet që nuk është lidhur me vullnet të lirë të debitorit. Tutje ka shtuar se vetë debitorit nuk ka mundur të paguajë detyrimin nga vendimi i Arbitrazhit para se të bëhej njohja e vendimit nga Gjykata vendore siç kërkohet me ligj, prandaj edhe i konteston kamatat e llogaritura sipas marrëveshjes së vitit 2017 si të jashtëligjshme.

41. Përkitazi me kundërshtimin e ekspertizës financiare, debitori ka propozuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare nga një grup i ekspertëve apo institucion profesional, me qëllim të sqarimit të plotë të gjendjes faktike e mbi bazën e së cilës mund të nxirret një vendim i ligjshëm. Për vëllim të detyrave të grupit të ekspertëve ka propozuar që të jenë:

- Kalkulimi i pagesave dhe shërbimeve të ofruara nga Telekom i Kosovës për kreditori Dardafon.net sipas marrëveshjes nr. 01-2124/17 e dt. 24.05.2017 për ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit me nr. 20990/MHM të dt. 09.12.2016
- Kalkulimi i saktë i kamatave ligjore dhe afateve kohore për fillimin e kalkulimit të kamatave nga data e plotfuqishmërisë së aktvendimit të gjykatës për shpalljen të ekzekutueshëm të vendimit të arbitrazhit dhe precizim të saktë të shumës së borxhit.

42. Bazuar në propozimin e sipërm Debitori me parashtrës dhe deklarim në seancë dëgjimore i ka propozuar gjykatës që paraprakisht të caktojë masën e sigurimit me të cilën detyrohet Kreditori Dardafon.net LLC që në një llogari të gjykatës apo në ndonjë llogari tjetër mirëbesimi të deponojë shumën e inkasuar në emër të borxhit përtej lartësisë së titullit ekzekutiv në vlerë 13'116'165.73 € deri në përfundimin e këtij procesi gjyqësor.

### **III. Vendimi i gjykatës**

43. Nga sa u tha më lartë, e në veçanti nga paragrafi 36 i këtij vendimi e tutje, duk iu përgjigjur udhëzimeve të vendimit të shkallës II të kësaj gjykate – listuar si në paragrafin 35 të arsytimit, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

#### ***a. Refuzimi i Ankesës së debitorit për parregullsi në procedurë përmbaremore***

44. Gjykata konstaton se në Ankesën e Debitorit të parashtruar për parregullsi në procedurë përmbaremore ishte ngritur si çështje fakti që kjo Gjykatë me Aktvendimin KPPP.nr.1996/22 dt. 27.10.2022 ia ka lënë kalkulimin financiar të borxhit të mbetur organit përmbareues, e ky i fundit ka pranuar vendimin gjyqësor me datën 28.10.2022 – në të njëjtën ditë ka nxjerrë Konkluzion për nxjerrje të provës me ekspertizë financiare, ndërkaq eksperti financiar me datën 31.10.2022 e ka përcjellë ekspertizën financiare të përfunduar. Përndryshe, kishte shtuar se vetë Debitori e ka pranuar vendimin e gjykatës në datën 31.10.2022. Në datën 01.11.2022 organi përmbareues i ka kërkuar Debitorit (përmes postës elektronike) që të përmbushë detyrimin në mënyrë vullnetare sipas ekspertizës financiare, në të kundërtën do të inkasohen mjetet në mënyrë të dhunshme. Lidhur me këtë, Debitori ka ngritur si çështje faktin se teknikisht dhe ligjërisht është e pamundur që brenda një ditë të analizohet dhe ekzekutohet vendimi gjyqësor i gjykatës, dhe që organi përmbareues në kohë kaq të shkurtë ti jap instruksione të qarta ekspertit financiar për nxjerrje të ekspertizës. Sipas tij, organi përmbareues nuk e ka udhëzuar ekspertin se si të veprojë në lidhje me llogaritjen e kamatave të përfshira në borxh, dhe nuk është marrë për bazë asnjë pretendim i debitorit e as nuk është kërkuar opinion apo dokument shtesë rreth përlllogaritjes së detyrimeve të përmbushura. Në datën 01.11.2022 pas pranimit të emailit nga organi përmbareues, i njëjti ka paralajmëruar parashtrimin e ankesës ndaj vendimit të gjykatës për vendosje sipas prapësimit. Nga këto

veprime te organit përmbaues në tërësi i njëjti konsideron se i është cenuar dinjiteti dhe dëmtuar imazhi i tij, për çka i propozon gjykatës që ankesën tij ta aprovojë si të bazuar dhe të anulohet Urdhri Përmbaues P.nr.491/19 dt. 15.07.2019 si të kundërligjshëm, si dhe ndaj organit përmbaues të ndërmerren masa sipas ligjit të zbatuar për udhëheqje të procedurë me gabime me vetëdije dhe në mënyrë të qëllimshme.

45. Pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve si në paragrafin e epërm, gjykata fillimisht verifikoi rregullsinë e dorëzimit të vendimit / Aktvendimin KPPP.nr.1996/22 dt. 27.10.2022 palëve ndërgjyqëse, sipas shkresave të lëndës, nga çka konstatohet se Avokati përfaqësues i Kreditorit – A.M. me seli të zyrës në Prishtinë, dhe Organi përmbaues Ilir Z. Mulhaxha me seli të zyrës në Prishtinë, e kanë pranuar secili në interes të vet (me ekspedime të ndara dhe individuale) vendimin e gjykatës në datën 28.10.2022. Kjo gjykatë, në çdo procedurë përmbauese të zhvilluar pranë saj, vendimet e nxjerra ia ekspedon çdoherë palës kreditore, debitore dhe organit përmbaues në mënyrë individuale. Se Debitori e ka pranuar vendimin e gjykatës në datën 31.10.2022, kjo çështje nuk paraqet ndonjë relevancë për trajtim të Ankesës për parregullsi në procedurë përmbauese. Fundja, është Shërbimi Postar i Kosovës që koordinon dhe operon dërgesat zyrtare nga institucionet gjyqësore tek të adresuarit. Gjkata si institucion i rendit publik dhe së drejtës, nuk është themeluar për të inspektuar orarin e punës së organeve përmbauese dhe / apo entiteteve të tjera, por është themeluar për të ushtruar pushtetin gjyqësor<sup>2</sup>, dhe në kuadër të autorizimeve që ka për zbatimin e ligjeve procedurale, ekspedimin e vendimit gjyqësor KPPP.nr.1996/22 dt. 27.10.2022 e konsideroi të rregullt dhe brenda orarit të punës – konform konstatimit që bëri në bazë të fletë kthesave të shërbimit postar të Postës së Kosovës (të cilat gjenden në shkresat e lëndës).

46. Se organi përmbaues ka vepruar menjëherë me nxjerrje të Konkluzionit për ekspertizë financiare dhe eksperti i caktuar i është përgjigjur me veprim konkret këtij konkluzioni, këtë gjykata e vlerësoi si efikasitet në procedurë të përmbauesit, pasi që organi përmbaues ka për detyrë të veprojë menjëherë pas pranimi të Aktvendimit, i cili është nxjerrë në vendosje sipas prapësimit; Fakti se Debitori ka ngritur kundërshtime apo paralajmërim për ngritje të ankesës, apo edhe paraqitja e ankesës nuk e ndalon procedurën përmbauese. Neni 77 par.

---

<sup>2</sup> Ligji nr. 06/1 - 054 për gjykatat, Neni 3 par. 1.

5 dhe 6 i Ligjit për procedurën përbarimore përcakton se “Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon procedurën përbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të këtij ligji. Në rast se debitori si palë ankuese është i suksesshëm në ankesën e tij dhe nëse pasuria e tij është përbaruar në pajtim me vendimin përbarimor, ai mund të kërkojë kundër përbarim sipas dispozitave të këtij ligji për kundër përbarimin.” Me analizimin e veprimeve të organit përbarues në frymën e kësaj dispozite, në shkresat e lëndës nuk u gjet ndonjë dëshmi se janë bllokuar llogaritë bankare të debitorit pa njoftim paraprak për përmbushje të detyrimit sipas ekspertizës financiare. Poashtu ekspertiza financiare dhe kërkesa për përmbushje të detyrimit nga ajo ka rrjedhë pas nxjerrjes së vendimit gjyqësor sipas prapësimit dhe jo pas urdhrin për përbarim, andaj nuk zbatohet edhe njëherë afati vullnetar i përmbushjes së detyrimit dhe nuk vihet në kontestim gjetja përfundimtare e borxhit të papaguar sipas titullit ekzekutiv, sepse kemi të bëjmë me një fazë ku kërkohet përmbushje e menjëhershme e detyrimit, dhe jo negociim, ankimim apo kundërshtim i borxhit (siç edhe i ka kërkuar organi përbarues debitorit me e-mailin e datës 01.11.2022). Lidhur me këto, Gjykata konsideron se organi përbarues me të drejtë ka vepruar sipas propozimit për inicim të procedurë përbarimore nga Kreditori i çështjes, dhe pas nxjerrjes së vendimit të kësaj gjykate KPPP.nr.1996/22 kishte vepruar me korrektësi në përmbushje të menjëhershme të të njëjtit.

Meqenëse Debitori në ankesën e tij nuk ka ngritur ndonjë çështje konkrete / apo veprim konkret të organit përbarues që e cilëson si të kundërligjshëm, dhe pretendimin se i është cenuar dinjiteti apo dëmtuar imazhi nuk i bëri të besueshëm me prova konkrete – as për procedurën e zhvilluar si tërësi e as për ndonjë veprim konkret në veçanti, konform nenit 79 lidhur me nenin 73 të LPP-së, Gjykata e refuzoi si të pabazuar Ankesën e Debitorit për parregullsi në procedurë përbarimore, si në pikën I të këtij Aktvendimi.

***b. Refuzimi i propozimit të Debitorit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit për pezullim të procedurës përbarimore P.nr. 491/19 dt. 15.07.2019***

47. Duke ndjekur udhëzimet e dhëna sipas vendimit të dhomës së shkallës II të kësaj gjykate, ashtu që të përcaktojë dhe trajtojë nëse Debitori ka parashtruar Kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të përbarimit apo vendosje të masës së sigurimit sipas dispozitave kontestimore, kjo gjykatë sqaron se nga analizimi i tërësishëm i përmbajtjes shkresore,

Debitori në këtë çështje kishte paraqitur 1). në datën 14.01.2022 Propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit për pezullim të përmbarimit P.nr.491/19 dt.15.07.2019, dhe 2. Propozim për caktimin e masës së sigurimit i datës 10.10.2022, i përsëritur në datën 4 dhe 25 prill 2022; Sa i përket vendosjes së pezullimit të procedurës përmbarimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.265/22 datë 07.02.2022 në vazhden e arsytimit të vendimit kishte theksuar se *“(...) tani për tani nuk mund të vendos lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit dhe se i mbetet gjykatës së shkallës së parë që të vendosë lidhur me propozimin e debitorit, nëse plotësohen kushtet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit.”*

48. Gjykata pasi ka shqyrtuar këtë propozim, vlerëson se përmbajtja e tij në esencë është propozim për vendosje të masë e përkohshme të sigurimit përmes shtyrjes së ekzekutimit të procedurës përmbarimore deri në marrjen e një vendimi përfundimtar meritore, pasi që edhe vet debitori në parashtrësë i është referuar dispozitave nga neni 296 par.1, 297 dhe 306 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK). Ndonëse kjo gjykatë ka vendosur një herë me Aktvendimin KPPP.nr.1996/22 me të cilin e kishte refuzuar propozimin e Debitorit për masën e përkohshme të sigurimit – për të adresuar me vendosje sipas sugjerimeve të dhomës së shkallës II, arsyeton si në vijim:

49. Propozimi për masë të përkohshme të sigurimit duhet të refuzohet për faktin së propozuesi i sigurimit ka dështuar ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës së tij dhe ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së përkohshme, debitorit do t'i shkaktohet dëm i pa riparueshëm dhe do t'i pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës së tij. Debitori me propozimin e tij ka pretenduar që nëse vazhdohet procedura e përmbarimit edhe më tej, mjetet e inkasuara për kreditorin nga llogaritë e debitori do të cenojnë interesat nacionale meqë kemi të bëjmë me një shoqëri aksionare në pronësi shtetërore, ndërkaq Kreditori do ti tjetërson ato mjete dhe ta pamundësojë realizimin e kërkesës së debitori që pretendon se ka bazë, e që do të vërtetohet me një vendim të drejtë, meritore dhe të ligjshëm deri në përfundim të procedurës. Mirëpo, lidhur me një pretendim të tillë, Debitori në asnjë fazë të procedurës të zhvilluar deri më tani dhe as në ri procedurë nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës së vet dhe as shkaktimin e rrezikut të tjetërsimit të mjeteve nga ana e

kreditorit (e që në fakt akoma nuk ka një titull juridike të qëndrueshëm për kërkesën e pretenduar ndaj kreditorit).

50. Për të adresuar juridikisht kërkesën e Debitori në të gjitha format ligjore që do të mund të vinin në shprehje në këtë rast, Gjykata vlerësoi poashtu propozimin e kreditorit edhe në suaza të shtyrjes së ekzekutimit të përmbarimit<sup>3</sup>, e që me nenin 61 të LPP-së përcaktohet se “*Organi përmbarues mund plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përmbarimin në situata ku debitori dëshmon përmes dokumenteve publike ose të vërtetuara se përmbarimi do t'i shkaktojë dëm të riparueshëm dhe jep si garanci shumën e cila së paku korrespondon me shumën e kërkesës*”. Përsëri edhe në këtë rrethanë, gjykata vlerësoi se Debitori në asnjë formë nuk e ka mbështetur me prova e fakte konkrete propozimin e tij dhe qëllimin mbi të cilin shtrihet ai. Sa i përket interesit nacional, në këtë procedurë palët dhe prestimet që kanë ndërmjet vete trajtohen ekskluzivisht mbi bazën e dokumentit përmbarimor – në këtë rast **titullit ekzekutiv** / Vendimit Përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr. 20990/MHM, datë 9 dhjetor 2016, i cili është **gjë e gjykuar** për një raport komercial që debitori me kreditorin ishin pajtuar mes vete, dhe nuk i përket kësaj gjykate të lëshohet në vlerësimin e pretendimeve rreth mbrojtjes së interesit nacional që ka Debitori. Fundja, kjo procedurë nuk është e karakterit kontestues.

51. Prandaj Gjykata nuk mund të ofrojë mbrojtje gjyqësore duke u mbështetur në supozimet e propozuesit të masës së përkohshme sigurimit, pasi që ka vlerësuar se propozimi për masë të përkohshme i referohet masave nga neni 300 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e që në rastin konkret në kuptim të dispozitës së nenit 297.1 pika (a) dhe (b) e LPK-së, propozuesi i masës së përkohshme të sigurimit ka dështuar ta bëjë të besueshme kërkesën e tij. Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

---

<sup>3</sup> Kjo, pasi që pezullimi i procedurës përmbarimore, konform nenit 68 të LPP-së, vie në shprehje taksativisht në keto raste:

“*Kur debitori apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllime të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre (3) muajve nga fillimi i rastit të përmbarimit, përkundër faktit se janë bërë së paku dy (2) tentime nga organi përmbarues që të gjej atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë; Kur është tentuar nga organi përmbarues që të zbatohet përmbarimi i vendimit së paku dy (2) herë pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime; Kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbarim vërtetohet se është e pasaktë ndërsa kreditori nuk mund të argumentojë para organit përmbarues saktësinë e adresës.*”



**c. Refuzimi i propozimit të Debitorit për caktimin e masës së sigurimit,**

52. Gjatë zhvillimit të procedurës në rivendosje, Debitori i çështjes ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurimit në dt. 10.10.2022, i përsëritur në datën 4 dhe 25 prill 2022 në seancat dëgjimore të mbajtura, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet Kreditori Dardafon.net LLC që deri në përfundim të procedurës gjyqësore përmbarimore, të deponojë në llogari të gjykatës apo në një llogari tjetër të veçantë mirëbesimi, mjetet e inkasuara përtej lartësisë së titullit ekzekutiv, në vlerë (të paktën) 13'116'165.73€ (*trembëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë e tre cent*) apo në vlerën e cila do të precizohet sipas gjetjes nga ekspertiza e re gjyqësore financiare nga grupi i ekspertëve. Pretendimin e tij për propozim të një mase të tillë, Debitori e mbështet nën argumentin se me pagesat e kryera ndaj kreditorit, e ka tejkaluar përmbarimin e detyrimit që rrjedh nga titulli ekzekutiv për vlerën 13'116'165.73€ (*trembëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë e tre cent*).
53. Mirëpo, kjo gjykatë nuk mundi ta marrë parasysh kërkesën për caktimin e një mase të tillë, pasi që nga shkresat e lëndës dhe provat përkatëse të cilat janë evidente në dosje, mund të konkludohet se transaksionet financiare të realizuara ndaj kreditorit janë bërë në emër të përmbarimit të borxhit që buron nga titulli ekzekutiv, respektivisht nga Marrëveshja e datës 17.11.2020 për përmbarim të borxhit nga vendimi i arbitrazhit, nga e cila, 14 kështe janë paguar nga 24 sa ishin të parapara në tërësi. Gjykata vlerëson se palët në procedurë këtë marrëveshje e kishin lidhur në kontinuitet për përmbarim të borxhit që derivon nga Vendimi si titull ekzekutiv dhe që është çështje e gjykuar, për këtë gjykata nuk ka tagër në këtë procedurë që të lëshohet në asnjë vlerësim të përmbarimit të marrëveshjes, përveç vlerësimit të përmbarimit të detyrimit i cili është objekt shqyrtimi i kësaj procedurë përmbarimore. Në momentin e ndërprerjes së pagesave të kësteve sipas marrëveshjes, Debitori ishte akoma në detyrim ndaj Kreditorit për 10 kështe pagesë të cilat rezultojnë në tërësi vlerën 7'499'736.00 € (shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë euro). Detyrimi pozitiv i debitorit ndaj kreditorit (dhe jo e kundërta) qëndron i konstatuar deri në përfundim të shqyrtimit në këtë çështje përmbarimore sipas Ekspertizës Financiare të datës 31.10.2022 e plotësuar në versionin e datës 10.01.2023. Prandaj gjykata nuk mund të marrë

për bazë pretendimin e pa mbështetur të debitorit për një kërkesë në procedurë përmbartimore, dhe ën pajtim me dispozitën e nenit 297 të LPK-së.

54. Pavarësisht vazhdës procedurale deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, dhe faktit se Gjykata Kushtetuese e i kishte kthyer Gjykatës së Apelit çështjen në rivendosje dhe ri procedurë, kjo procedurë përmbartimore si tërësi, nuk është nisur për të ballafaquar kompensime të shërbimeve në mes të palëve në procedurë, por për të ekzekutuar një titull përmbartimor i cili si i tillë buron nga një gjë e gjykuar / Vendimi përfundimtar i Arbitrazhit. Se Debitori pretendon të ketë paguar më shumë se çka kërkohet në bazë të Vendimit të Arbitrazhit, gjykata vlerëson se këtë kërkesë i njëjti mund ta inicioje në procedurën e kundër përmbartimit apo ta vërtetojë në procedurë kontestimore, dhe jo të mbajë peng zhvillimin e kësaj procedure përmbartimore me një masë sigurimi / bllokim të mjeteve të Kreditorit.

55. Ligji për procedurën kontestimore është i qartë në kërkesat që duhet të përmbushen për tu siguruar e drejta e kreditorit / propozuesit të masës, me normën e nenit 297, i cili përcakton se: “297.1 Masa e sigurimit mund të caktohet:

a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe

b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

297.2 Po që se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, ashtu siç parashihet me Ligjin mbi Procedurën Përmbartimore, jep garanci në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit.

297.3 Po që se propozuesi nuk jep garanci brenda afatit të caktuar gjykata e refuzon propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Me kërkesën e propozuesit gjykata mund ta liroj atë nga detyrimi i dhënies së garancisë po që se konstatohet se nuk ka mundësi financiare për një gjë të tillë.”

56. Sipas dispozitës së lartëcekur, par. 2 i nenit 297 LPK, Gjykata konsideron se është jo efikase dhe jo ekonomike për palën Debitorë caktimi i çfarëdo lloji të masës së sigurimit ndaj Kreditorit sepse vetë Debitori do të obligohej që të paguajë një garanci financiare në vlerë ekuivalente të dëmit që do të mund t'i shkaktonte Kreditorit me vendosjen e masës së sigurimit. Si rrjedhojë, buxheti i Debitorit do të ngarkohej me një garanci të konsiderueshme, ndërkaq deri në këtë fazë të zhvillimit të procedurës Debitori gjendet akoma në detyrim ndaj Kreditorit. Prandaj për gjykatën vendosja e një mase sigurimi sipas propozimit të Debitorit do të ishte më tepër ngarkesë e dyfishuar për te, sesa ndihmese në përmbushje të detyrimit që lind nga titulli ekzekutiv. Meqenëse Debitori është shoqëri aksionare me likuiditet pozitiv, do të ishte e palogjikshme çfarëdo kërkesë potenciale për lirim nga pagesa e garancionit, në mbështetje të kërkesës për caktim të masës së sigurimit.

57. Si përfundim, nga sa u elaborua si në paragrafët e epërme, meqenëse Debitori nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës së tij si dhe nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e saj do të pamundësohej apo vështirësohej realizimi i kërkesës së tij në ndenë formë, Gjykata e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së tillë, si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

#### *d. Refuzimi i Prapësimit të Debitorit*

58. Pas shqyrtimit të pretendimeve të Debitorit të dhëna në prapësimin e datës 18.07.2019, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.491/19 datë 15.07.2019 të Përmbarruesit Privat Ilir Z. Mulhaxha, i plotësuar me parashtrësën e dt. 10.10.2022, duke marrë parasysh dhe duke zbatuar të gjitha sugjerimet e dhëna me vendimin nga Dhoma e shkallës II të Gjykatës Komerciale të Kosovës, duke siguruar respektimin e parimit të barabarësisë së palëve dhe zbatimin e së drejtës për një gjykim të drejtë, e udhëhequr mbi parimin e rigorozitetit formal në procedurën e përmbarrimit – kjo gjykatë, si gjykatë e cila trajton mjetin juridik të goditjes së urdhrit përmbarrimor, ka vendosur që të refuzojë në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, për shkaqet dhe arsytet që do të elaborohen si në vijim.

59. Organi përmbareues, pas pranimit të vendimit KPPP.nr.1996/22 i datës 27.10.2022 ka vazhduar procedurën e përmbareimit dhe ka nxjerrë Konkluzion (dt. 28.10.2022)për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, ndërkaq për ekspertin ka caktuar R.S.. Sipas Konkluzionit të organit përmbareues, si dhe sipas ekspertizës financiare e poashtu sqarimeve të dhëna të ekspertit financiar në seancën e datës 25.04.2023, gjykata vlerësoi se detyrat për nxjerrje të provës me ekspertizë financiare janë dhënë në mënyrë të duhur dhe në kuadër të kufijve të titullit përmbareimor, në raport me zhvillimet në procedurë përmbareimore si deri më tani.
60. Eksperti financiar, ka llogaritur mbetjen e borxhit të pa përmbushur sipas përmbajtjes së Konkluzionit të organit përmbareues dhe të: vlerësimi i borxhit dhe përlllogaritja e kamatës mbi bazën e borxhit të mbetur të debitorit sipas Konkluzionit përmbareimor P.nr. 491/196 dt. 13.07.2019, bazuar në propozim / Urdhrin për përmbareim të të njëjtit numër, mbi borxhin e debitorit Telekom i Kosovës Sh.A. ndaj kreditorit Dardafon.net LLC nga Vendimi përfundimtar i Odës së Arbitrazhit në Londër 20990/MHM dt. 9.12.2016, si dhe në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës I, Departamenti për Çështje ekonomike KPPP.nr.1996/2022 dt. 27.10.2022.
- Me rastin e fillimit të punimit të ekspertizës, eksperti ka deklaruar se ka kërkuar edhe informacione shtese nga kreditori i përmbareimit lidhur me pagesat eventuale të pranuar nga debitori – edhe pse shumicën i ka pasur në dispozicion. Tutje ka hartuar ekspertizën financiare që daton me 31.10.2022, e ndaj të njëjtës ka pranuar vërejtjet e ngritura nga ana e Debitorit. Pas pranimit të vërejtjeve të debitorit, janë mbajtur dy seanca dëgjimore pranë organit përmbareues me palët në procedurë, dhe atë me 23.12.2022 dhe 10.01.2023. Para seancës së dytë, eksperti ka theksuar se i ka përcjellë me shkrim përgjigjet në të gjitha pyetjet e parashtruara nga Debitori i çështjes, ndërkaq pas seancës së dytë është hartuar Plotësim Ekspertiza Financiare Përfundimtare në këtë proces, e evidentuar me datën 10.01.2023.
61. Në pyetjen e parashtruar nga Gjykata në seancën e datës 25.04.2023, se sa është borxhi i mbetur i debitorit ndaj kreditorit sipas plotësim ekspertizës përfundimtare, eksperti është përgjigjur se borxhi i mbetur i debitorit është 5'732'871.34 € (*pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent*). Deri te përlllogaritja përfundimtare e borxhit, Eksperti ka sqaruar në këtë seancë se me detaje dhe nga dokumentacioni ekzistues në shkresat e lëndës, përlllogaritja e borxhit është bërë

fillimisht duke u nisur nga propozimi dhe Urdhri për përmbarim e më pastaj në bazë të marrëveshjes se arritur mes palëve në procedurë, e dt. 17.11.2020, si dhe në bazë të pagesave të realizuara nga ana e debitorit në ndërkohë. Për këtë ka shtuar se nuk është kalkuluar vlera 1'660'000.00 € (*një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë euro*) si dhe kamatat përkatëse të kalkuluara më parë - gjithnjë sipas dispozitivit të Aktvendimit të kësaj gjykate, datë 27.10.2022 - si dhe janë larguar të gjitha kamatat e përlogaritura sipas planit të amortizimit për periudhat vijuese nga ndërprerja e pagesave nga ana e debitorit. Mbi këtë bazë është kalkuluar shuma e mbetur e borxhit, me pastaj janë kalkuluar kamatat e reja nga konstatimi i borxhit.

62. Lidhur me deklarin e dhënë, gjykata ka shqyrtuar për së afërmi Plotësim ekspertizën financiare të datës 10.01.2023 të Ekspertit R.S. (*tutje Ekspertiza*), me vëmendje të shtuar dhe kujdes të plotë, për të verifikuar nëse përlogaritja e kryegjësë dhe kamatave i përgjigjet gjendjes reale të prestimeve mes palëve në këtë procedurë, sa i përket ekzekutimit të Vendimit përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr. 20990/MHM, datë 9 dhjetor 2016 konform marrëveshjes për përmbushje të borxhit dt. 17.11.2020. Sipas Ekspertizës, pas pranimit të Konkluzionit nga organi përmbarues, marrë për bazë zhvillimin e tërësishëm të kësaj procedure përmbarimore, Eksperti ka kërkuar sqarime shtesë nga Kreditori si iniciues i procedurës, meqë ka konsideruar se ka informata të domosdoshme që mungojnë për llogaritje të borxhit e ato janë: Marrëveshja e fundit me debitorin, Pagesat e kryera mbi këtë marrëveshje deri në momentin e përpilimit të ekspertizës dhe Raporti i pagesave / plani i pagesave të kryera dhe dëshmitë përkatëse, ashtu që të arrihet te baza për përlogaritjen e kamatës nga vlera e saktë e borxhit.

63. Sipas Ekspertizës, palët ishin pajtuar me Marrëveshjen e datës 17.11.2020 , Marrëveshje kjo e vërtetuar në seancë dëgjimore me Konkluzion sipas procesverbalit i përpiluar pranë organit përmbarues Ilir Z. Mulhaxha dt. 18.12.2020, se borxhi i konstatuar me këtë marrëveshje arrin shumën prej 17'281'141.00€, i cili është kalkuluar pas zbritjes së pagesave nga borxhi i përgjithshëm, të cilat i kishte paguar në ndërkohë debitori Telekom i Kosovës Sh.A. ndaj Kreditorit Dardafon.net LLC, si dhe interesat e përlogaritura mbi këtë borxh në vlerën 718,224.43 €. Nga kjo konstatohet se borxhi total i dakorduar mes palëve në procedurë ishte

17,999,366.41 € i cili është paraparë të paguhet në 24 këste, me vlerë mujore të kështit 749'973.30 €.

64. Sipas ekspertizës, pikënisje e llogaritjeve është konstatimi i borxhit të lartëcekur, gjegjësisht marrëveshja përkatëse dhe zbatimi i saj sipas planit të amortizimit të pagesave të ndara në 24 këste mujore, plan ky i cili ka qenë i nënshkruar si pjesë integrale e marrëveshjes së ri formalizuar me Konkluzion mes palëve në seancën e organit përbarimor të dt. 18.10.2020. Sipas tabelës së amort planit të pagesave – e cila është pjesë integrale e marrëveshjes, debitorit kishte paguar 14 nga 24 këstet e borxhit, konkretisht kishte paguar shumën 10'499'634.97 €. Sipas ekspertizës, kjo vlerë është konstatuar edhe në bazë të dëshmimeve të pagesave dhe përmbushja e të njëjtave nuk është kundërshtuar nga asnjëra palë në procedurë – ndonëse këstet nuk janë paguar me përpikëri nga debitorit sipas planit në afatet e rregullta kohore.
65. Për shkak të vazhdës së procedurës gjyqësore (të cilat janë theksuar me qëndrimet e debitorit që në hyrje të arsyetimit të këtij vendimi), Debitorit ka ndërprerë pagesat e kësteve në datën 22.02.2022, dhe borxhi i pa përmbushur në këtë datë i Debitorit rezultonte të jetë 7'499'736.00 €, i cili ishte planifikuar të paguhet në shpërndarjen mujore nga 15 Mars 2022 – 15 Dhjetor 2022. Në këtë shumë të mbetur të borxhit është i kalkuluar interesi përkatës i cili ka vlerën 135'235.65 €.
66. Nga shuma e mbetur si në paragrafin e epërm, Eksperti Financiar ka zbatuar pikën I të dispozitivit të Aktvendimit KPPP.nr.1996/2022 me të cilën shfuqizohet pika II (c) e Urdhrit Përbarimor P.nr.491/19 datë 15.07.2019 (kamatat ndëshkuese të llogaritura në baza ditore), dhe ka zbritur nga vlera e borxhit si në paragrafin e epërm, shumën 1'660'000.00 € me të gjitha kamatat ndërlidhëse. Paraprakisht Eksperti ka konstatuar se nuk është hasur në asnjë dokument tjetër se është llogaritur kamata apo se është dashur të përfshihet kamata mbi këtë shumë sipas përlllogaritjes së borxhit. Prandaj edhe është rishikuar i gjithë interesi / të gjitha kamatat e paguara dhe ato të mbetura për pagesë mbi këtë shumë – e që në fakt nuk do të duhej të përfshihen në bazën e borxhit për përlllogaritje të interesit<sup>4</sup>. Nga kjo rezultoi se duke

---

<sup>4</sup> Në ekspertizë theksohet se këtë sqarim Eksperti ia ka dhënë debitorit me përgjigje në formë pas të shkruar pyetje të parashtruara deri në mbajtjen e seancës dëgjimore të datës 10.01.2023 pranë organit përbarues (fq. 10, “*e shpjeguar ne dokumentin Përgjigjet ne vërejtjet e debitorit*”).

marre parasysht eliminimin e kamatave të kalkuluara për periudhën e papaguar të 10 kësteve të mbetura nga marrëveshja, për periudhën 15.02 - 15.12.2022 në shumën përfundimtare 135'235.65 €, borxhi i mbetur shprehet dhe llogaritet si në vijim:

Kryegjësja: 4'178'681.84 € dhe Interesat e përlllogaritur si borxh 3'185'818.52 € e që së bashku rezultojnë me totalin e borxhit të Debitorit ndaj Kreditorit sipas marrëveshjes së pa përmbushur për shlyerje të borxhit nga Vendimi përfundimtar i Arbitrazhit në shumën 7'364'500.36 €. Më pas, vlerës së dhënë të kryegjësës (4'178'681.84 €,) eksperti ia ka zbritur shumat 1'660'000.00 € dhe kamatat e paguara mbi këtë vlerë (30.380.27€ të paguara pa nevojë nga Debitori, dhe 100'439.55 € të paguara sipas amort planit të pagesave konform marrëveshjes deri me 15.02.2022 nëpër 14 këste të përmbushura). Nga kjo në total rezulton që kryegjësja e mbetur e borxhit është në vlerë 2'387'862.02 €.

67. Në vijim, sipas Aktvendimit KPPP.1996/22, Eksperti ka llogaritur kamatëvonesën në lartësi 8% sipas dispozitave të zbatuara të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve mbi kryegjësën e borxhit të mbetur në 10 këste të papaguara (kamatëvonesë 8% mbi shumën 2'387'862.02 €) e cila arrin lartësinë 159'190.80€. Dhe këtu përfundon përlllogaritja përfundimtare e detyrimit të Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A. ndaj Kreditorit Dardafon.net LLC, sipas vlerave të mbetura për pagesë me sa vijon:

- Kryegjësja e borxhit të mbetur për pagesë nga marrëveshja e pa përmbushur (pas zbritjes së gjobave me kamatat përkatëse sipas Aktvendimit KPPP.nr.1996/22), në vlerë 2'387'862.02€ + Interesat e përlllogaritur si borxh nga marrëveshja e pa përmbushur, në vlerë 3'185'818.52€ + Kamatëvonesa 8% e llogaritur mbi kryegjësën e mbetur për pagesë nga marrëveshja e pa përmbushur, në vlerë 159'190.80€, e që në **total rezulton të jetë me vlerën 5'732'871.34 € (pesë milionë e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent).**

68. Si përfundim, gjykata vlerësoi edhe konstatimin profesional përfundimtar të ekspertit, marrë për bazë edhe sqarimet të cilat i ka dhënë në seancën dëgjimore të datës 25.04.2023 e mbajtur në këtë gjykatë në ri procedurë, ku theksohet se ndryshimet e bëra në përlllogaritje të detyrimit të mbetur të Debitorit ndaj Kreditorit janë reflektuar në këtë plotësim ekspertizë konform me Konkluzionin e dhënë nga organi përmbarues në seancën e datës 10.01.2023 – pas marrjes

parasysh të deklarimeve dhe vërejtjeve të debitorit të çështjes. I njëjti ka theksuar së për këtë çështje – sipas kërkesës së Debitorit – nuk ka qenë e mundur të bëhet përlllogaritja e interesit shtesë në favor të Debitorit, përderisa nuk është bërë pagesa e tërësishme e borxheve dhe nuk ka pasur pagesa me përshkrim të veçantë për borxhin e caktuar. Çdo interes i kalkuluar dhe paguar mbi shumën 1'660'000.00 € është zbritur dhe anuluar me këtë ekspertizë. Për fund, Eksperti financiar ka konstatuar në ekspertizën financiare se *“ekspertiza paraqet gjendjen e obligimeve financiare mbi bazën e informatave të siguruara deri në finalizimin e ekspertizës. Të gjitha përlllogaritjet janë bërë mbi bazën e supozimeve të drejta dhe duke u bazuar në të dhëna faktike. Pas datës së kësaj ekspertize mund të ketë ndryshime të obligimeve ndërmjet palëve ndërgjyqëse – përmbare, për të cilat ky raport nuk mund të paragjykojë, dhe nuk mbanë përgjegjësi për ndonjë ndryshim të të dhënave faktike pas datës së këtij raporti.”*

69. Nga sa u tha më lartë, par. 59 – 68 i këtij vendimi, Gjykata i fali besimin ekspertizës financiare të punuar nga Eksperti financiar R.S., e datës 10.01.2023, pasi që u bind se e njëjta është e qartë, e mbështetur në udhëzimet e dhëna sipas aktvendimeve e konkluzioneve përkatëse, është gjithëpërfshirëse në kuptim të trajtimit të titullit ekzekutiv dhe marrëveshjes së palëve në procedurë për përmbushje të detyrimit që rezulton nga ky titull, dhe mbështetet në fakte e dëshmitë e pagesave përkatëse të realizuara nga ana e debitorit deri në datën e përpilimit të ekspertizës. Në analizimin e thukët të përpunimit financiar që u gjet me këtë ekspertizë, kjo gjykatë vlerëson se nuk ka asnjë përlllogaritje kontradiktore sa i përket kryegjësë së borxhit, interesit të llogaritur si borxh dhe interesit në lartësi 8% për shumën e pa përmbushur të detyrimit sipas marrëveshjes së datës 17.11.2020 që palët në procedurë kishin lidhur në mes veti.

70. Ndonëse Debitori e ka kundërshtuar këtë ekspertizë në vazhdimësi edhe gjatë mbajtjes së seancave dëgjimore në ri procedurë, gjykata vlerëson se kundërshtimet dërmuese shtrihen mbi mënyrën e llogaritjes së interesit mbi borxh, por që nga elaborimit dhe rishikimi i hollësishëm i ekspertizës financiare, kjo gjykatë u bind se kundërshtimet e debitorit janë të paqëndrueshme. Gjykata erdhi në përfundim se këto kundërshtime janë të pabazuara, pasi që baza dhe pikënisja e tërë kalkulimit të detyrimit të debitorit është Vendimit Përfundimtar i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (OEN) Nr. 20990/MHM, datë 9 dhjetor 2016, dhe Marrëveshja për ekzekutimin e borxhit nga ky vendim e datës 17.11.2020, si dhe barazimet



e pagesave e prestimeve me dëshmi përkatëse – e që me sa u sqarua në paragrafët 59 – 68 të këtij arsytimi të vendimit, nuk ka mospërputhje të kalkulimeve apo rezultat konfliktuoz numerik.

71. Edhe pse Debitori kundërshtimet e tija i mbështeti deri në përfundim të procedurës në argumentin se Marrëveshja për ekzekutimin e borxhit e datës 17.11.2020 është lidhur nën trysni të një vendimi gjyqësor (Ac.nr.3610/20 dt. 8.10.2020) i cili është anuluar me Vendim të Gjykatës Kushtetuese (KI 84/21 dt. 24.11.2021), dhe për atë arsye kjo marrëveshje (për shlyerje të borxhit me amort plan në 24 këste) nuk duhet të merret parasysh - gjykata vlerëson se çështja përmbartimore si në këtë lëndë është kthyer në ri procedurë dhe ri vendosje për garantim të zbatimit të të drejtave të palëve në procedurë, siç është e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm dhe E drejta për një proces të rregullt, e që implementimi i të njëjtave nuk nënkupton detyrimisht anulim / rënie të borxhit. Nuliteti i kontratës apo dispozitës përkatëse të kontratës së datës 17.11.2020 në raport me të drejtat dhe detyrimet që kanë rrjedhur nga ajo, si dhe vlerësimi i ligjshmërisë së kontratës duhet të bëhet në procedurë kontestimore dhe jo në procedurë përmbartimore. Poashtu, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk është lëshuar për vendosje në merita të rastit por ka udhëzuar në respektimin e parimit të barazisë së palëve në procedurë dhe garantimin e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të pa anshëm – gjë e cila iu mundësua palëve të kësaj çështjeje përmbartimore në Gjykatën Komerciale – Dhomat e shkallës I, ashtu që përmes seancave dëgjimore të mbajtura dhe shqyrtimit të propozimeve e pretendimeve të tyre, është arritur deri te verdikti përfundimtar si në këtë vendim, konform dispozitave ligjore të zbatueshme në këtë procedurë.

72. Prandaj, gjykata konsideron se propozimi i Debitorit për nxjerrjen e provës me ekspertizë të re financiare nga një grup i ekspertëve (1) për kalkulim të pagesave dhe shërbimeve të ofruara nga Telekom i Kosovës për kreditori Dardafon.net sipas marrëveshjes nr. 01-2124/17 e dt. 24.05.2017 për ekzekutimin e vendimit final te arbitrazhit me nr. 20990/MHM te dt. 09.12.2016, si dhe (2) Kalkulimin e saktë të kamatave ligjore dhe afateve kohore për fillimin e kalkulimit të kamatave nga data e plotfuqishmërisë së aktvendimit të gjykatës për shpalljen të ekzekutueshëm të vendimit te arbitrazhit dhe precizim të saktë të shumës së borxhit, është jo relevant. Kjo sepse, çfarëdo rezultati i një ekspertize të tillë do të rezultonte në saldosh të borxhit e cila është krijuar pas pagesave nga një marrëveshje pasuese për ekzekutim të

borxhit, siç është marrëveshja e datës 17.11.2020, sepse palët i kanë akorduar prestimet e tyre në këtë marrëveshje si në kuptim të lartësisë, ashtu edhe kompensimeve dhe zhvleftësimit të marrëveshjeve tjera paraprake gojore. Për këto arsye, gjykata me aktvendim burimor në seancën e datës 25.04.2023 e ka refuzuar propozimin e Debitorit për nxjerrje të ekspertizës financiare.

73. Nga sa u tha më lartë, mbi bazën e arsytimit të dhënë të vendimit, pasi që gjykata i falë besimin ekspertizës financiare – plotësimit të saj të datës 31.01.2023 të realizuar në procedurë përmbartimore nga Eksperti financiar R.S., duke konkluduar për vendosjen si në këtë aktvendim, duke përkujtuar palët se sipas nenit 69 dhe 71 të Ligjit për procedurën përmbartimore lidhur me nenin 13 par. 1.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, kompetencë e kësaj gjykate për të vendosur në lëmi përmbartimore është vetëm vendosja sipas prapësimit, duke udhëzuar palët në procedurë që për çështje të tjera të natyrës kompensuese sa i përket pretendimeve për prestime të mbetura dhe të pa barazuara – t'i adresojnë ato në procedurë kontestimore, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi – pika IV dhe V e tij, duke e refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar në tërësi, duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor të Përmbartuesit Privat Ilir Z. Mulhaxha P.nr.491/19 dt. 15.07.2019, për çka obligoi Debitorin Telekom i Kosovës Sh.A. që të përmbushë detyrimin e mbetur nga Vendimi përfundimtar i Arbitrazhit ndaj Kreditorit Dardafon.net LLC në shumën 5'732'871.34 € (pesë milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një euro e tridhjetë e katër cent), në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

74. Vendimi i gjykatës është nxjerrë jashtë seancës gjyqësore në kuptim të dispozitës nga neni 73 i Ligjit për procedurën përmbartimore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 365/2023, datë 17.07.2023

Gjyqtari

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.